



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 04, dt. 13.03.2019

*Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 si kontribut finanziar për pjesëmarrje në konkurimin ndërkombëtar për anglisht folësin më të mirë të të rinjve shqiptarë*

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nen 77, Ligjin Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise”, Ligjin nr. “Për Buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 13 date 11.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratoje përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 në vlerë 300 mijë lekë si kontribut finanziar për pjesëmarrje të të rinjve nga shkollat e mesme të Qarkut në konkurimin ndërkombëtar për anglisht folësin më të mirë të të rinjve shqiptarë, organizuar nga English-Speaking Union Albania.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimeve në Keshillin e Qarkut.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi  
Juristi Gj.Kristo  
Sek.K.Qarkut B. Muço





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KESHILLI I QARKUT KORÇE

Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Sherbimeve

#### Relacion

*Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 si kontribut finanziar per pjesemarjen ne konkurrimin nderkombetar per anglisht folesin me te mire te te rinvje shqiptare*

Me ftese te English – Speaking Union Albania, Keshilli i Qarkut eshte ftuar te behet pjese e organizimit te aktiviteti per pjesemarje ne konkurrimin nderkombetar te anglisht folesit me te mire te te rinvje shqiptare. Kjo organizate eshte pjese e organizes English-Speaking Union International me qender ne Angli. Qellimi i kesaj organizate eshte perfshirja masivisht e te gjithe te rinvje shqiptare ne garat e anglisht folesve me te mire si dhe ne aktivitete te tjera internacionale. Qellimi i fteses per bashkepunim me ESU eshte nje mundesi unike per te integruar jo vetem te rinvje, por edhe institucionin dhe rajonin ne teresi.

Qellimi i ketij aktiviteti eshte ngritura e kapaciteteve komunikuese te te rinvje per te perballuar krizen ekonomike dhe identifikimi i urave lidhese midis sistemit te edukimit dhe biznesit me qellim uljen e papunesise dhe aftesimin e te rinvje qe ne bankat e shkolles me kerkesat e tregut te punes.

Ngritura e kapaciteteve komunikuese te te rinvje parashikohet te behet permes realizimit te konkurseve te te folurit ne publik. Element inovativ i ketij projekti eshte qe trajnimet dhe konkursset do te zhvillohen ne gjuhen angleze. Ne kete konkurs te te folurit publik do te marin pjese te rinvje nga mosha 14 deri 20 vjet nga i gjithe teritori i Shqiperise.

Zhvillimi i ketij aktiviteti do te kaloje ne disa faza si:

- Pergatitja e materialeve udhezuese per trajnimin e te rinvje qe do te marin pjese.
- Fushate promocionale ne te gjithe teritorin e vendit\
- Trajnimi i stafit pedagogjik te shkollave qe do te ndjekin studentet neper rrethe
- Organizimi i te gjithe fazave te konkurseve deri ne eventin final
- Perfaqesimi i fituesve shqiptare ne aktivitetin nderkombetar qe do te zhvillohet ne Angli
- Shperndarja e eksperiencies se fituar dhe sugjerimet per te ardhmen

Monitorimi i ketij aktiviteti si dhe eksperiencat e meparshme, qe keto institucione kane, do te konsistoje ne monitorimin e vazhdueshem te te rinvje qe marin pjese.

Konkursi i te folurit ne publik do te zhvillohet ne te gjithe teritorin e vendit duke perfshire te rind brenda e jashte vendit dhe parashikohet te zhvillohet ne muajt Janar – Maj 2019

Nga ana jone ne bashkepunim me drejtorite e shkollave te mesme te rajonit tone do te punohet per perzgjedhjen e nxenesve me te mire dhe mbeshtetjen e tyre per te mare pjese denjesisht ne kete aktivitet te rendesishme.

Per realizimin e ketij aktiviteti nga ana e English – Speaking Union Albania eshte kerkuar nje mbeshtetje financiare prej 2500 euro ose 300 mijë leke.

Duke mare ne konsiderate rendesine e ketij aktiviteti si dhe impaktin qe ka ai ne integrimin e te rinjve shqiptare ne Bashkimin Europian, propozojme Keshillit te Qarkut miratimin e ketij kontributi finanziar dhe perdorimin e fondit rezerve per vitin 2019 ne vlore 300 mijë leke, mbeshtetur dhe ne Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neri 77, Ligjin Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin “Për Buxhetin e viti 2019”, ne Udhezimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, ne Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 13 date 11.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019”.

Liljana Pleqi

Drejtore e Finances

Korce, me 11.03.2019

